



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

RREGULLORE

PËR
REGJISTRIN ELEKTRONIK ONLINE TË SHITJEVE TË KONTRATAVE
TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM MOTORIK

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 23, datë 26.02.2018

Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 188, datë 18.09.2018

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave të funksionimit, të identifikimit dhe raportimit të të dhënave të shitjes të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve, të instaluar në Qendrën e Informacionit pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore del në zbatim të nenit 38, pika 1/c, 2 dhe 5 të Ligjit nr.10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, ndryshuar me Ligjin nr. 10455, datë 21.7.2011.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore është e detyrueshme për t’u zbatuar nga shoqëritë e sigurimit, shoqëritë e agentëve, punonjësit e shoqërive të sigurimit, si dhe nga agentët në sigurime të licencuar nga AMF, të cilët ushtrojnë veprimtari në klasat që lidhen me sigurimin e detyrueshëm motorik.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Policë”-është kontrata e sigurimit të detyrueshëm motorik për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, policat e kartonit jeshil dhe policat e

sigurimit kufitar.

2. “Përdorues i autorizuar”- janë punonjësit e shoqërive të sigurimit, agentët e shoqërive të sigurimit apo të shoqërive të agentëve, të cilët janë të licencuar nga AMF.

Neni 5

Shitja dhe Raportimi i policave në regjistrin online të shitjeve

1. Shoqëria e sigurimit, agentët/shoqëritë e agentëve duhet të marrin të gjitha masat për të identifikuar dhe raportuar shitjen në kohë reale të çdo police sigurimi të detyrueshëm motorik, në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve të sigurimeve të detyrueshme motorike, të instaluar në Qendrën e Informacionit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

1.1 Pavarësisht përcaktimeve të pikes 1 të këtij neni, shoqëritë e sigurimit, agentët/shoqëritë e agentëve mund të raportojnë shitjen, në një kohë të mëvonshme vetëm kur është në përputhje me dispozitat e specifikuara sipas Aneksit 3 të kësaj rregulloreje dhe miratohet me shkrim nga drejtuesit ekzekutivë të Autoritetit.

2. Shoqëria e sigurimit, agentët/shoqëritë e agentëve marrin të gjitha masat për të përshtatur sistemet informatike respektive të shitjeve online të policave për të operuar në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje. Një përdorues i autorizuar nuk mund të kryejë shitjen e policave të sigurimit nga më shumë se një terminal shitjeje dhe vendodhje.

2.1 Shoqëria e sigurimit njofton paraprakisht Autoritetin për sistemet e saj të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik. Këto sisteme duhet të paktën të përmbushin këto kritere:

- a. Të ofrojnë akses të pakufizuar për shitjen e policave në çdo kohë që agjenti kërkon të lëshojë një policë.
- b. Të identifikojnë agentët në mënyrë unike duke përdorur kodin e miratuar nga AMF.
- c. Çdo agjent i cili ka akses për shitje policash të më shumë se një shoqërie sigurimi duhet të ketë një kopje të marrëveshjes në ambientet e tij, e cila e lejon aksesin në to.
- d. Sistemi që përdor agjenti për shitjen e policave të detyrueshme duhet të jetë pjesë e sistemit të shoqërisë për të cilin është licencuar duke u lidhur drejtëpërdrejtë me të pa ndërjyrje nga sisteme të tjera të paautorizuara.

Shoqëria e sigurimit informon Autoritetin (Drejtoria e IT) për skemën e rrjetit dhe të gjitha sistemeve përgjegjëse për shitjen apo raportimin e policave nëpërmjet një shkrese zyrtare dhe e-mail-it (it@amf.gov.al). Njoftimi kryhet përpara se të ndodhin ndryshimet në rrjet apo në sisteme duke u shoqëruar me qëllimin e ndryshimit.

AMF mbart të drejtën që të ushtrojë detyrën e saj në mbikëqyrjen e këtyre sistemeve në çdo kohë duke marrë për bazë këto kritere por edhe të tjera bazuar në standardet e auditimit të sistemeve të informacionit dhe teknologjisë.

3. Polica e sigurimit identifikohet nëpërmjet numrit unik të gjeneruar automatikisht nga Regjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike dhe printohet në hapësirën përkatëse të policës. Shitja e policave nuk duhet të realizohet në

rast se mungon numri unik i gjeneruar nga Regjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike.

4. Shoqëritë e sigurimit, agentët/shoqëritë e agentëve duhet të marrin masat që numri i serisë së policës të jetë unik për të gjitha produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik që ofron shoqëria dhe të mos përsëritet në vitet në vazhdim. Ky numër duhet të fillojë çdo vit me dy shifrat e fundit të vitit aktual. (Shembull: Viti 2018 = 18xxxxxxx).
5. Shoqëria e sigurimeve, agentët/shoqëritë e agentëve njoftojnë Autoritetin për punonjës/punonjësit e autorizuar. Për çdo ndryshim në lidhje me punonjës/punonjësit e autorizuar për administrimin e sistemeve informatike respektive të shitjes online, shoqëria e sigurimeve duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin brenda 24 orëve.

Neni 6

Kostot e administrimit dhe mirëmbajtjes

1. Shoqëria e sigurimit është përgjegjëse për mbulimin e të gjitha investimeve dhe shpenzimeve të nevojshme për garantimin e funksionimit të pandërprerë të Regjistrit Elektronik Online të Shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik, si dhe mirëmbajtjen e tij.
2. Shoqëritë mbulojnë kostot për përditësimin apo përmirësimin në të ardhmen të Regjistrit sa herë që të lind nevoja.
3. Autoriteti është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe administrimin e serverave (parësor dhe backup) të Regjistrit Elektronik Online të Shitjeve të instaluar në Qendrën e Informacionit. Në rast të daljes jashtë funksionimit të serverave të mësipërm, shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të vënë në dispozicion servera të përshtatshëm për vazhdimin e raportimit.
4. Ruajtja fizike dhe elektronike e të dhënave që regjistrohen në sistem do të kryhet në Qendrën e Informacionit, në ambjentet e AMF-së dhe të ambjentit ku do të vendoset serveri Back-Up nga personeli i autorizuar i AMF-së.
5. Suporti teknik dhe identifikimi i nevojave për përmirësim kryhet nga personeli i autorizuar nga AMF.

Neni 7

Specifikimet teknike

1. Regjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorik gjeneron një numër unik i cili ka karakteristikat e renditura në Aneksin 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje.
2. Skema e detajuar dhe karakteristikat e procesit të identifikimit dhe raportimit të shitjeve të policave është paraqitur në Aneksin 2 bashkëngjitur kësaj rregulloreje.
3. Komunikimi i sistemeve informatike respektive të shitjeve me Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike në funksion të dhënies së aksesit përdoruesve të autorizuar, duhet të realizohet nëpërmjet dy linjave të komunikimit (parësore dhe back-up) Per secilen nga linjat e komunikimi duhet të përdoren adresa unike IP.

Neni 8

Mënyra e funksionimit

1. Të dhënat e kërkesës për shitje nga shoqërinë e sigurimit vijnë në kohe reale në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik.
2. Për çdo kërkesë programi gjeneron automatikisht një numër unik të rastësishëm i cili shtypet në policë në momentin e lëshimit.
3. Ky numër i rastësishëm është unik dhe i trajtës alfanumerike dhe shërben për të vërtetuar raportimin e policës në bazën e të dhënave qendrore në Autoritet.
4. Fillimi i periudhës së vlefshmërisë së policës nuk duhet të jetë më e vonë se 30 ditë nga data e shitjes/ nënshkrimit të saj.
 - 4.1 Në përjashtim me pikën 4 të këtij neni periudha e vlefshmërisë së policës mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e shitjes/nënshkrimit të saj në rastet kur shoqëria e sigurimit është fituese në një procedurë prokurimi për pajisjen me polica të sigurimit të detyrueshëm motorik të një subjekti. Në këtë rast shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin, i cili pasi shqyrton kërkesën mundëson raportimin e këtyre kontratave sipas kërkesës përkatëse duke i caktuar shoqërisë së sigurimit një afat për realizimin e procesit.
 - 4.2 Raportimi i të dhënave duhet të kryhet sipas dispozitave të kësaj rregulloreje dhe pa ndryshime të të dhënave të raportuara në krahasim me ato të printuara në policën e sigurimit të detyrueshëm motorik.
5. Autorizimi apo pezullimi i përdoruesve që raportojnë në Regjistrin Online të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike realizohet sipas procedurës në Aneksin 4 bashkëngjitur kësaj rregulloreje.
6. Anullimet e policave do të kryhen vetëm nga personeli i autorizuar i shoqërisë së sigurimit jo më shumë se 30 ditë nga data e fillimit të vlefshmërisë së policës.
 - 6.1 Në rastet e riaktivizimit kur kemi të bëjmë me anullim gabimisht të policave TPL dhe Kufitare, duhet të raportohen në drejtorinë e IT në AMF në e-mailin support@amf.gov.al si dhe në it@amf.gov.al, brenda 24 orësh ndërsa për policat e kartonit jeshil duhet të raportohen brenda 4 orësh.
7. Shoqëria e sigurimit duhet të kryejë raportimin të dhënave të një police sigurimi në mënyrë jo të përsëritur, për një mjet të caktuar duke u bazuar në numrin e shasisë për të njëjtën periudhë vlefshmërie.
8. Shoqëria duhet të reflektojë në Regjistrin Online të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike rastet kthimit të policave, duke bërë përditesimin e statusit të policës në statusin “I Kthyer”.

Neni 9

Dispozita të fundit

1. Rastet e evidentimit të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik të paidentifikuara, me numrin unik në Regjistrin Elektronik Online të Shitjes së Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, rastet me numër identifikimi të dubluar, rastet me numër identifikimi jo korrekt, rastet e verifikimit të ndryshimeve të të dhënave të raportuara në krahasim me ato të printuara, rastet e cënimit të sigurisë së sistemit, përbëjnë shkelje të dispozitave ligjore në fushën e sigurimit dhe konsiderohen të parregullta dhe subjekti që i ka emetuar konsiderohet se kryen veprimtari të jashtëligjshme.
2. Çdo veprim i parashikuar në paragrafin e mësipërm, i cili bie në kundërshtim me kërkesat e kësaj rregulloreje, është objekt sanksionimi sipas parashikimeve të nenit 52 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, neneve 199, 201, 246 dhe 247 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe neneve 31 dhe 32 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

ANEKSI 1

Karakteristikat specifike të gjenerimit të numrit unik identifikues të policës së sigurimit në regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorrik.

- Formati do të jetë:
{KLASA, KODI I AGJENTIT, PESE NUMRAT E FUNDIT TË SHASISE, HASH (HASH=algoritmi i enkriptimit i cili nuk do të jetë sekuencial dhe do të aprovohet nga AMF)} në total jo më shumë se 30 karaktere.
- Për inpute do të përdoren Klasa e Automjetit sipas kategorizimit të Urdhërit të Ministrisë të Financave, Kodi i agjentit, informacione të policës si koha e lëshimit, targa e automjetit, shasia, patentat.
- Të gjenerojë numra të rastësishëm sipas një algoritmi të përcaktuar nga Autoriteti.
- Numrat e gjeneruar të jenë unik.
- Algoritmi të ndryshohet vetëm me miratim nga Autoriteti.
- Të mos realizohet shitja në rast se mungon numri unik i raportimit.

ANEKSI 2

I. Skema e detajuar dhe karakteristikat e procesit të identifikimit dhe raportimit të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorrik.

• Kërkesa për policë të re

1. Operacioni Fillestar i web service-it [doLogin](#)
2. Operacioni i dytë i web service-it [doRequest](#)
3. Operacioni i tretë i web service-it [doGetVehicleData](#)
4. Operacioni i pestë i web service-it [doGetBonusMalusData](#)
5. Operacioni i gjashtë i web service-it [doSendData](#)
6. Operacioni i shtatë i webservice-it [DoSendPaymentData](#)
7. Operacioni i tetë i web service-it [doSavePolice](#)

• Anullimi i një policë ekzistuese

1. Operacioni Fillestar i web service-it [doLogin](#)
2. Operacioni i dytë i web service-it [doCancelPoliceRequest](#)
3. Operacioni i tretë i web service-it [doCancelPolice](#)

• Dublikimi i një policë ekzistuese

1. Operacioni Fillestar i web service-it [doLogin](#)
2. Operacioni i dytë i web service-it [doRequest](#)
3. Operacioni i tretë i web service-it [doDuplicatePoliceRequest](#)
4. Operacioni i katërt i web service-it [doGetVehicleData](#)
5. Operacioni i gjashtë i web service-it [doSendDataForDuplicate](#)
6. Operacioni i shtatë i web service-it [doSaveDublikate](#)

- **Kthimi i një policë ekzistuese**

1. Operacioni fillestar i web service-it [doLogin](#)
2. Operacioni i dytë i web service-it [doReturnPoliceRequest](#)
3. Operacioni i tretë i web service-it [doSendReturnData](#)
4. Operacioni i katërt i web service-it [doReturnPolice](#)

II. Web service-i i hostuar në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, për Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të detyrueshëm Motorik.

Web service-i mund të aksesohet me adresë URL të aprovuar vetëm nga Autoriteti.

Radha e veprimeve që duhet të kryhen për si dhe për të marrë në mënyrë të sukseshme numrin unik (kodi i policës) të gjeneruar nga ky regjistër vijon si më poshtë.

A. Kërkesa për policë të re

1. **Përdoruesi thërret një instancë të web service-it.**
2. **Ruan sesionin për instancën e mësipërme.**
3. **Thirret operacioni fillestar i web service-it [doLogin](#).**

Ky operacion merr dy parametra:

- a. Përdoruesin – variable i tipit string. Në bazën e të dhënave të AMF-së duhet të ekzistojë një përdorues i vlefshëm me po të njëjtin emër.
- b. Fjalëkalimin - variable i tipit string. Në bazën e të dhënave të AMF-së duhet të ekzistojë një fjalëkalim i vlefshëm për përdoruesin në fjalë

Pas lidhjes me sukses me Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve me përdorues dhe fjalëkalimin e përshtatshëm, kthehet një përgjigje për regjistrim të suksesshëm, në të kundërt kthehet një mesazh gabimi.

4. **Thirret operacioni i dytë i web service-it [doRequest](#).**

Ky operacion merr 4 parametra:

- a. Kodin e Shoqërisë së Sigurimit – variable i tipit string.
- b. Kodin e Agjensisë – variable i tipit string.
- c. Kodin e Agjentit – variable i tipit string.
- d. Kodin e llojit të policës – variable i tipit string.

Pasi është bërë kërkesa nga përdoruesi dhe ajo ka rezultuar e vlefshme, web service-i kthen përgjigje për pranim të kërkesës, në të kundërt kthehet një mesazh gabimi që shpjegon arsyen e gabimit.

5. **Thirret operacioni i tretë i web service-it [doGetVehicleData](#).**

Ky operacion merr si parameter targën ose numrin e shasisë.

Mundëson ndërveprimin dhe konsultimin me [ëebservice](#) të Drejtorisë së Përgjithshme të

Transportit Rrugor. (DPSHTRR-së) nëpërmjet thirrjes së një metode java të integruar në bazën e të dhënave për të marrë informacionin mbi një automjet të caktuar në një datë të caktuar në bazë të targës ose shasisë dhe mundëson marrjen e të dhënave të mjetit dhe pronarit nga DPSHTRR.

Parametrat e kërkesës:

Plate

- String;
- Targa shqiptare e mjetit;
- E detyrueshme.

VIN

- String;
- Shasia e mjetit;
- Opsionale.

6. Thirret operacioni i pestë i web service-i t [doGetBonusMalusData](#).

Ky operacion mer si parameter Numrin Personal.

Mundëson marrjen e të dhënave nga Regjistrat Bonus dhe Malus.

Parametrat e kërkesës:

Tipi

- 1: Informacion i thjeshtë
 - 2: Informacion i zgjeruar
- Tipi Informacion i zgjeruar i shton përgjigjes parametrin BM_HISTORY i cili përmban më tepër të dhëna mb historikun bonus malus

Numër Personal

- String;
- Numër personal shqiptar;
- I detyrueshëm

7. Thirret operacioni i gjashtë i web service-it [doSendData](#).

Ky operacion merr si parametra të gjitha të dhënat për policën. Parametrat vijojnë si më poshtë:

Nr.	Parametri	Gjateisa	Detyrueshëm?	Pershkrimi
1	Nr. Serial i policës.	VARCHAR2(7)	PO	---
2	Nr. i shitjes së policës.	NUMBER	PO	---
3	Data e shitjes.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
4	Data e fillimit të policës.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy

5	Data e mbarimit të policës.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
6	Data e pagesës së policës.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
7	Primi i policës.	NUMBER	PO	---
8	TVSH-ja.	NUMBER	PO	---
9	Total i policës.	NUMBER	PO	---
10	Kodi i shoqërisë.	VARCHAR2(2)	PO	---
11	Kodi i agjensisë.	VARCHAR2(2)	PO	---
12	Kodi i agjentit.	VARCHAR2(8)	PO	---
13	Kodi i kategorisë së mjetit.	VARCHAR2(2)	PO	---
14	Kodi i klasës së mjetit.	VARCHAR2(2)	PO	---
15	Kodi i llojit të policës.	VARCHAR2(2)	PO	1 - TPL 2 - Kartoni Jeshil 3 - Polica Kufitare
16	Kodi i periudhës së policës.	VARCHAR2(2)	PO	0 - 1 vjecare (TPL) 1 - 1 vjecare 2 - 15 ditore 3 - 20 ditore 4 - 25 ditore 5 - 30 ditore 6 - 45 ditore
17	Nr. Shasisë së mjetit.	VARCHAR2(18)	PO	---
18	Nr i lejes së qarkullimit.	VARCHAR2(7)	JO	---
19	Shënime për policën.	VARCHAR2(250)	JO	Shënime të mundshme për policën.
20	Targa e mjetit.	VARCHAR2(20)	PO	---
21	Marka e mjetit.	VARCHAR2(50)	PO	---
22	Modeli i mjetit.	VARCHAR2(50)	PO	---
23	Ngjyra e mjetit.	VARCHAR2(20)	PO	---

24	Viti i prodhimit i mjetit.	NUMBER(4)	PO	---
25	Nr. i vendeve të mjetit.	NUMBER(3)	PO	---
26	Kapaciteti bartës i mjetit.	NUMBER	PO	---
27	Fuqia motorike e mjetit	NUMBER	PO	---
28	Shenime për mjetin.	VARCHAR2(250)	JO	Shënime të mundshme për mjetin.
29	Nr. patentës i pronarit.	VARCHAR2(20)	JO	---
30	Emri i pronarit.	VARCHAR2(30)	PO	---
31	Mbiemri i pronarit.	VARCHAR2(30)	PO	---
32	Emri i babait të pronarit.	VARCHAR2(30)	JO	---
33	Gjinia e pronarit.	VARCHAR2(1)	PO	M ose F
34	Datëlindja e pronarit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
35	Nipti i pronarit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të klientit.	Nese tipi i klientit është subjekt, atëherë plotësimi i kësaj fushe është e detyrueshme.
36	Kodi fiskal i pronarit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të klientit.	Nëse tipi i klientit është subjekt, atëherë plotësimi i kësaj fushe është e detyrueshme.
37	Adresa e pronarit.	VARCHAR2(100)	JO	---
38	Nr. telefoni i pronarit.	VARCHAR2(20)	JO	---
39	Nr. fax i pronarit.	VARCHAR2(20)	JO	---
40	Nr. celularit i pronarit.	VARCHAR2(20)	JO	---

41	Kodi tipit të klientit.	VARCHAR2(1)	PO	Plotësohet me një nga karakteret e mëposhtme 1 - pronar 2 – përdorues 3 – subjekt
42	Nr. patentës i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	PO	---
43	Data eleshimit të patentës të përdoruesit të parë të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
44	Data e skadimit të patentës të përdoruesit të parë të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
45	Klasa e patentës të përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(2)	JO	---
46	Emri i përdoruesit të parë të mjetit	VARCHAR2(30)	PO	---
47	Mbiemri i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(30)	PO	---
48	Emri i babait të përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(30)	JO	---
49	Gjinia e përdoruesit të parë të mjetit	VARCHAR2(1)	PO	---
50	Datelindja e përdoruesit të parë të mjetit.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
51	Nipti i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të klientit.	---
52	Kodi fiskal i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	Ne varësi të kodit të tipit të klientit.	---
53	Adresa e përdoruesit të parë mjetit.	VARCHAR2(100)	JO	---
54	Nr. telefonit i përdoruesit të parë të mjetit	VARCHAR2(20)	JO	---
55	Nr. fax të përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
56	Nr. Celularit të përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---

57	Kodi tip klienti i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(1)	PO	Plotësohet me një nga karakteret e mëposhtme 1 - pronar 2 – përdorues 3 – subjekt
58	Nr patentës i përdoruesit të dytë, të mjetit.	VARCHAR2(18)	JO	
59	Data e leshimit të patentës të përdoruesit të dytë të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
60	Data e skadimit të patentës të përdoruesit të dytë, të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
61	Klasa e patentës e përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(2)	JO	
62	Emri i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(30)	JO	
63	Mbiemri i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(30)	JO	
64	Emri i babait i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(30)	JO	
65	Gjinia e përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(1)	JO	M ose F
66	Datelindja e përdoruesit të dytë të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
67	Nipti i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të klientit.	Plotësohet nëse përdoruesi i dytë është subjekt.
68	Kodi fiskal i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të klientit.	---
69	Adresa e përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(100)	JO	---
70	Nr. telefonit i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---

71	Nr. fax i përdoruesit të dytë , të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
72	Nr. celularit i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
73	Kodi tip klienti i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(1)	JO	Plotësohet me një nga karakteret e mëposhtme 1 - pronar 2 – përdorues 3 – subjekt

Të gjitha parametrat e këtij operacioni dërgohen si strings sipas formateve të përcaktuara më lart.

Në qoftë së të dhënat e dërguara plotësojnë kushtet e lartpërmendura atëherë, kthehet një përgjigje për marrjen me sukses të të dhënave, në të kundërt, kthehet një mesazh gabimi që shpjegon arsyen e gabimit.

8. Thirrjet operacioni i shtatë i web servis-it [doSendPaymentData](#)

Mer si parameter:

- a. kodin e transaksionit bankar - Variabli i tipit String, i cili gjenerohet nga banka përkatëse.
- b. tipin e transaksionit bankar - Variabli i tipit String.
Plotësohet me një nga karakteret e mëposhtme:
 - 1 urdhërshirim
 - 2 derdhje në llogari
 - 3 pos
 - 4 e-banking
 - 5 tjetër
 - 6 tender
- c. kodi i bankës - Variabli i tipit String
Plotësohet me një nga karakteret e mëposhtme:
 - 1 Banka Raiffeisen
 - 2 Banka Kombëtare Tregtare
 - 3 Banka Intesa SanPaolo
 - 4 Banka Credins
 - 5 Banka ProCredit
 - 6 Banka Union
 - 7 Banka Alpha
 - 8 Banka Kombetare e Greqise
 - 9 Banka e Parë e Investimeve
 - 10 Banka Tirana
 - 11 Banka Societe Generale
 - 12 Banka Emporiki
 - 13 Veneto Banka
 - 14 Banka e Bashkuar e Shqipërisë
 - 15 Banka e Kreditit të Shqipërisë
 - 16 Banka Ndërkombëtare Tregtare
 - 17 tjetër

Kontrolli i transaksioneve:

Në rast suksesi në marrjen dhe kontrollin e transaksionit bankar kthehet kodi 100 dhe vazhdon procedura e shitjes. Në të kundërt kthen një mesazh gabimi me kodin përkatës.

9. Thirret operacioni i tetë i web service-it [doSavePolice](#).

Ky operacion i Web Service-it nuk kërkon asnjë parametër. Në qofte së të dhënat ruhen me sukses atëherë thirrësit i kthehet kodi i policës dhe lidhja me bazën e të dhënave shkëputet, në të kundërt, gjenerohet një mesazh gabimi.

B. Anullimi i një policë ekzistuese

Rradha e operacioneve të web service-it që duhet të thirren për të kryer anulimin e një police vijon si më poshtë.

- 1. Klienti thërret një instancë të web service-it.**
- 2. Ruan sesionin për instancën e mësipërme.**
- 3. Thirret operacioni fillestar i web service-it [doLogin](#).**

Ky operacion merr dy parametra:

- a. Përdoruesin – variable i tipit string. Në bazën e të dhënave të AMF-së duhet të ekzistojë një përdorues i vlefshëm me po të njejtin emer.
- b. Fjalëkalimim - variable i tipit string. Në bazën e të dhënave të AMF-së duhet të ekzistojë një fjalëkalim i vlefshëm për përdoruesin në fjalë

Pas lidhjes me sukses me bazën e të dhënave me përdorues dhe fjalëkalimin e përshtatshëm, kthehet një përgjigje për login të suksesshëm, në të kundërt kthehet një mesazh gabimi.

4. Thirret operacioni i dytë i web service-it [doCancelPoliceRequest](#).

Ky operacion merr një parametër të vetëm, kodin e policës që dëshirohet të anulohet. Psh.

[doCancelPoliceRequest\(<kodi i policës>\)](#)

Nëse polica është në një status i cili mund të anulohet atëherë web service-i kthen një përgjigje për pranim me sukses të kërkesës për anullim, në të kundërt kthehet një mesazh gabimi.

5. Thirret operacioni i tretë i web service-it [doCancelPolice](#).

Ky operacion i web service-it nuk merr asnjë parametër në hyrje. Në qofte së anulimi kryhet me sukses atëherë kthehet një përgjigje për anullim të suksesshëm të policës, në të kundërt kthehet një mesazh gabimi.

C. Dublikimi i një police ekzistuese

Rradha e operacioneve të web service-it që duhet të thirren për të kryer dublikimin e një policë vijon si më poshtë.

- 1. Klienti thërret një instancë të web service-it.**
- 2. Ruan sesionin për instancën e mësipërme.**

3. Thirrjet operacioni fillestar i web service-it **doLogin**.

Ky operacion merr dy parametra:

- a. Përdoruesin – variable i tipit string. Në bazën e të dhënave të AMF-se duhet të ekzistojë një përdorues i vlefshëm me po të njëjtin emër.
- b. Fjalëkalimin - variable i tipit string. Në bazën e të dhënave të AMF-se duhet të ekzistojë një fjalëkalim i vlefshëm për përdoruesin në fjalë

4. Thirrjet operacioni i dytë i webservice-it **doRequest**

Ky operacion i web service-i t merr si parametra (company_code, agency_code, agent_code, police_type_code)

Pas lidhjes me sukses me bazën e të dhënave me përdorues dhe fjalëkalimin e përshtatshëm, kthehet një përgjigje për login të suksesshem, në të kundërt kthehet një mesazh gabimi.

5. Thirrjet operacioni i tretë i web service-it **doDuplicatePoliceRequest**.

Ky operacion i ëeb service-i t merr në hyrje një parametër të vetëm, kodin e policës që kërkohet të publikohet. Pasi kryhet një kontroll për statusin e policës që dëshirohet të publikohet, web service-i kthen një përgjigje për praninë të kërkesës, ose për mospraninë të saj pasi në statusin që ndodhet policia nuk mund të publikohet.

6. Thirrjet operacioni i katërt i webservice-i t **doGetVehicleData**

Ky operacion merr si parameter targetin ose numrin e shasisë.

Mundëson interagimin me webservice të Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor. (DPSHTRR-së) nëpërmjet thirrjes së një metode java të integruar në bazën e të dhënave për të marrë informacionin mbi një automjet të caktuar në një datë të caktuar në bazë të targës ose shasisë.

Mundëson marrjen e të dhënave të mjetit dhe pronarit nga DPSHTRR.

Parametrat e kërkesës:

- Plate (TARGA)
 - String;
 - Targa shqiptare e mjetit;
 - E detyrueshme
- VIN (NR SHASISË)
 - String;
 - Shasia e mjetit;
 - Opsionale

7. Thirrjet operacioni i gjashtë i web service-i t **doSendDataForDuplicate**.

Nr.	Parametri	Gjatësia	Detyrueshëm	Përshkrimi
1	Nr. Serial i policës.	VARCHAR2(7)	PO	---

2	Nr. i shitjes së policës.	NUMBER	PO	---
3	Data e shitjes.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
4	Data e fillimit të policës.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
5	Data e mbarimit të policës.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
6	Data e pagesës së policës.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
7	Primi i policës.	NUMBER	PO	---
8	TVSH-ja.	NUMBER	PO	---
9	Total i pagesës.	NUMBER	PO	---
10	Kodi i shoqërisë.	VARCHAR2(2)	PO	---
11	Kodi i agjensisë.	VARCHAR2(2)	PO	---
12	Kodi i agjentit.	VARCHAR2(8)	PO	---
13	Kodi i kategorisë së mjetit.	VARCHAR2(2)	PO	---
14	Kodi i klasës së mjetit.	VARCHAR2(2)	PO	---
15	Kodi i llojit të policës.	VARCHAR2(2)	PO	1 - TPL 2 - Kartoni Jeshil 3 - Polica Kufitare
16	Kodi i periudhës së policës.	VARCHAR2(2)	PO	0 - 1 vjeçare (TPL) 1 - 1 vjeçare 2 - 15 ditore 3 - 20 ditore 4 - 25 ditore 5 - 30 ditore 6 - 45 ditore
17	Nr. Shasisë së mjetit.	VARCHAR2(18)	PO	---
18	Nr i lejes së qarkullimit.	VARCHAR2(7)	JO	---
19	Shënime për policën.	VARCHAR2(250)	JO	Shënime të mundshme për policën.

20	Kodi i policës që dëshirohet të dublikohet	VARCHAR2(18)	PO	---
21	Targa e mjetit.	VARCHAR2(20)	PO	---
22	Marka e mjetit	VARCHAR2(50)	PO	---
23	Modeli i mjetit.	VARCHAR2(50)	PO	---
24	Ngjyra e mjetit.	VARCHAR2(20)	PO	---
25	Viti i prodhimit i mjetit.	NUMBER(4)	PO	---
26	Nr. i vendeve të mjetit.	NUMBER(3)	PO	---
27	Kapaciteti bartës i mjetit.	NUMBER	PO	---
28	Fuqia motorike e mjetit.	NUMBER	PO	---
29	Shenime për mjetin.	VARCHAR2(250)	JO	Shënime të mundshme për
30	Nr. patentës i pronarit.	VARCHAR2(20)	JO	---
31	Emri i pronarit.	VARCHAR2(30)	PO	---
32	Mbiemri i pronarit.	VARCHAR2(30)	PO	---
33	Emri i babait të pronarit.	VARCHAR2(30)	JO	---
34	Gjinia e pronarit.	VARCHAR2(1)	PO	M ose F
35	Datëlindja e pronarit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
36	Nipti i pronarit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të	Nese tipi i klientit është subjekt, atëherë
37	Kodi fiskal i pronarit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të	Nese tipi i klientit është subjekt, atëherë
38	Adresa e pronarit.	VARCHAR2(100)	JO	---
39	Nr. telefoni i pronarit.	VARCHAR2(20)	JO	---
40	Nr. fax i pronarit.	VARCHAR2(20)	JO	---
41	Nr. celularit i pronarit.	VARCHAR2(20)	JO	---
42	Kodi tipit të klientit.	VARCHAR2(1)	PO	Plotësohet me një nga karakteret e

43	Nr. patentës i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	PO	---
44	Data e leshimit të patentës të përdoruesit të parë të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
45	Data e Skadimit të patentës të përdoruesit të parë të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
46	Klasa e patentës të përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(2)	PO	---
47	Emri i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(30)	PO	---
48	Mbiemri i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(30)	PO	---
49	Emri i babait të përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(30)	JO	---
50	Gjinia e përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(1)	PO	---
51	Datelindja e përdoruesit të parë të mjetit.	DATE	PO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
52	Nipti i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të	---
53	Kodi fiskal i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	Ne varësi të	---
54	Adresa e përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(100)	JO	---
55	Nr. telefonit i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
56	Nr. fax të përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
57	Nr. Celularit të përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
58	Kodi tip klienti i përdoruesit të parë të mjetit.	VARCHAR2(1)	PO	Plotësohet me një nga karakteret e
59	Nr patentës i përdoruesit të dytë, të mjetit.	VARCHAR2(18)	JO	
60	Data e leshimit të patentës të përdoruesit të dytë të mjetit	DATE	JO	Data duhet të jetë në format

61	Data e skadimit të patentës të përdoruesit të dytë, të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
62	Klasa e patentës e përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(2)	JO	
63	Emri i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(30)	JO	
64	Mbiemri i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(30)	JO	
65	Emri i babait i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(30)	JO	
66	Gjinia e përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(1)	JO	M ose F
67	Datelindja e përdoruesit të dytë të mjetit.	DATE	JO	Data duhet të jetë në format dd.mm.yyyy
68	Nipti i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të klientit.	Plotësohet nëse përdoruesi i dytë është subjekt.
69	Kodi fiskal i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(20)	Në varësi të kodit të tipit të klientit.	---
70	Adresa e përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(100)	JO	---
71	Nr. telefonit i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
72	Nr. fax i përdoruesit të dytë, të mjetit	VARCHAR2(20)	JO	---
73	Nr. celularit i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(20)	JO	---
74	Kodi tip klienti i përdoruesit të dytë të mjetit.	VARCHAR2(1)	JO	Plotësohet me një nga karakteret e mëposhtme 1 - pronar 2 – përdorues 3 – subjekt

Të gjitha parametrat e këtij operacioni dërgohen si stringa sipas formateve të përcaktuara më lart.

Në qoftë se të dhënat e dërguara plotësojnë kushtet e lartpërmendura atëherë, kthehet një përgjigje për marrjen me sukses të të dhënave, në të kundërt, kthehet një mesazh gabimi që shpjegon arsyen e gabimit.

8. Thirrjet operacioni i shtatë i web service-it [doSaveDublikatë](#).

Ky operacion i web service-it nuk merr asnjë parametër në hyrje. Në qoftë se dublikimi i policës përfundon me sukses, atëherë web service-i kthen kodin e policës dublikate, në të kundërt kthehet një mesazh gabimi ku shpjegohen arsyet e gabimit.

D. Kthimi i Policave

- 1. Klienti thërret një instancë të web servisit.**
- 2. Ruan sesionin për instancën e mësipërme.**
- 3. Thirrjet operacioni fillestar i web servisit [doLogin](#).**

Ky operacion merr dy parametra:

- Përdoruesin – variable i tipit string. Në bazën e të dhënave të AMF-së duhet të ekzistojë një përdorues i vlefshëm me po të njejtin emër.
- Fjalëkalimin – variable i tipit string. Në bazën e të dhënave të AMF-së duhet të ekzistojë një fjalëkalim i vlefshëm për përdoruesin në fjalë.

Pas lidhjes me sukses me bazën e të dhënave me përdorues dhe fjalëkalimin e mësipërm, kthehet një përgjigje për login të suksesshëm, në të kundërt kthehet një mesazh gabimi.

Vlerat që kthehen:

100 - U lidhet me bazën e të dhënave.

101 - Përdorues/Fjalëkalim i pavlefshëm.

102 - Nuk jeni i lidhur me bazën e të dhënave.

4.Thirrjet operacioni i dytë i web servisit [doReturnPoliceRequest](#).

Ky operacion merr një parametër të vetëm, kodin e policës që do t'i kthehet klientit. Nëse polica është në një status që mund të kthehet (SHITUR dhe DUBLIKATË), brenda periudhës së vlefshmërisë dhe përdoruesi ka të drejtë për të kryer këtë operacion, atëherë web service kthen një përgjigje për pranim me sukses të kërkesës për kthim, në të kundërt kthehet një mesazh gabimi.

Vlerat që kthehen:

100 - Kërkesa për anulim police u pranua.

101 - Polica e kërkuar nuk u gjet në sistem ose është jashtë afateve të kthimit.

102 - Nuk jeni i lidhur me bazën e të dhënave.

103 - Kjo adresë nuk është e autorizuar të kthejë polica për këtë Shoqëri.

104 - Polica ndodhet në status që nuk mund të kthehet, ose përdoruesit nuk i lejohet kthimi për këtë policë. Sigurohuni që polica në fjalë i përket kompanisë tuaj.

5. Thirrjet operacioni i tretë i web servisit [doSendReturnData](#).

Ky operacion mund të thërretet nëqë kanë kaluar me sukses dy operacionet e mësipërme. Merr një parametër, vlerën e primit të kthyer e cila duhet të jetë e tipit numër dhe nuk duhet të

lidhet pa plotësuar. Në qoftë se vlera e primit plotëson kriteret, atëherë web service kthen përgjigje pozitive, në të kundërt kthehet një mesazh gabimi.

Vlerat qe kthehen:

100 – Të dhënat e primit të kthyer u morën me sukses.

110 – 'Primi Kthyer' nuk duhet të lihet pa plotësuar.

120 – 'Primi Kthyer' duhet të jetë i tipit numër.

102 – Nuk jeni i lidhur me bazën e të dhënave.

103 – Bëni me parë një kërkesë për kthim police.

6. Thirret operacioni i katërt i web servisit [doReturnPolice](#).

Ky operacion i web service-i nuk merr asnjë parametër në hyrje. Në qoftë se kthimi i policës kryhet me sukses atëherë kthehet një përgjigje për kthim të suksesshëm të policës, në të kundërt kthehet një mesazh gabimi.

Vlerat qe kthehen:

100 - Polica u kthye me sukses.

102 - Nuk jeni i lidhur me bazën e të dhënave.

103 - Bëni më parë një kërkesë për kthim.

Në rast se kthimi kryhet me suksese atëherë polica kalon në statusin 5 (kthyer) dhe vendoset edhe vlera e primit të kthyer në të dhënat e policës. Përveç tyre kuptohet që në backend mbahen të dhënat e datës së kthimit dhe përdoruesit që ka vepruar për këtë policë.

ANEKSI 3

1. Procedura e raportimit jo në kohë reale është raportimi i policave nga shoqëritë e sigurimit në Regjistrin Elektronik Online të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, në një datë të mëvonshme se ajo e nënshkrimit të polices. Raportimi jo në kohë reale lejohet vetën në raste të veçanta kur ka mosfunksionim të Regjistrin Elektronik Online të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik.

2. Procedura e raportimit offline do të konsiderohet vetëm për rastet kur Regjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik shfaq probleme madhore deri në mosfunksionimin e plotë të tij.

3. Nga momenti kur Regjistri është sërish online, shoqëria ka afat 5 ditë pune që të dërgoj shkresë zyrtare dhe e-mail Autoritetit (support@amf.gov.al) duke përfshirë të gjitha policat e mosraportuara gjatë kësaj periudhe. AMF vazhdon me procedurën e raportimit në regjister të këtyre policave duke ndjekur hapat e mëposhtme:

a. Informacioni mbi policat raportohet nëpërmjet serverit të shoqërisë;

b. Drejtoria TI e shoqërisë bashkërendon procesin me Drejtorinë TI të Autoritetit ditën-orarin e mundësimit të raportimit;

c. Çdo policë e raportuar në këtë mënyrë shoqërohet me shënimin e datës dhe numrit të protokollit të shkresës së pare origjinale.

4. Shoqëria e sigurimit mer të gjitha masat e nevojshme për të regjistruar për një periudhë 3 ditore të gjitha policat e paraportuara me datën e shitjes, pas miratimit të këtij raportimi nga Autoriteti.

ANEKSI 4

Autorizimi (hapja) dhe pezullimi (mbyllja) e përdoruesve që raportojnë në regjistrin online të sigurimeve të detyrueshme motorike.

Konfigurimi i një përdoruesi të ri në Regjistrin Elektronik Online të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik nënkupton krijimin e një kodi unik sipas një formati i realizuar sipas logjikës së aplikacionit duke zbatuar hierarkinë: Agjensi, agjent, përdoruesi.

1. Autorizimi (hapja) e një përdoruesi të ri

- Pas kërkesës së paraqitur nga shoqëria e sigurimit apo shoqëria e agjentëve për punonjësit shitës të policave ose për agjentët në emër të saj, me të cilën ka lidhur kontratën e agjentit, Zyra e Licencimit autorizon Drejtorinë TI për hapjen e përdoruesit/përdoruesve në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve.
- Drejtoria TI hap përdoruesin e ri dhe vijon komunikimin me personin e autorizuar TI të shoqërisë së sigurimit;

Rrethi	Emër Agjencie	Kod Agjencie	Kod Agjenti	Përdorues	Emër	Mbiemër	Adresa	Identifikimi			Tel/cel
								Nipt	Nr. Sigurime shoqerore	Nr. Personal	

Shënime:

- Nipt:** Eshtë Nuis i agjentit / shoqërisë së sigurimit
- Nr. Sig. Shoqërore:** Plotësohet nga shoqëria e sigurimit/ agjentit
- Procesi i punës:**

- Modeli plotësohet në të gjitha fushat;
- Dërgohet bashkëngjitur me e-mail në adresën: licencimi@amf.gov.al duke vendosur në cc: një drejtues të shoqërisë;

Në rast pranimi nga Zyra e Licencimit, Drejtoria e TI procedon me konfigurimin dhe komunikon rezultatin me e-mail.

2. Pezullim (mbyllje) përdoruesi në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik

Pezullimi i një përdoruesi në sistem nënkupton mbylljen e kodit duke zbatuar hierarkinë: Mbylljen e përdoruesit, mbylljen e kodit të agjentit.

- Pas kërkesës së paraqitur nga shoqëria e sigurimit pranë AMF, me të dhënat si më poshtë:
 - Emër, Mbiemër i agjentit
 - Kod i agjentit
 - Emrin e shoqërisë së sigurimit

Zyra e Licencimit autorizon Drejtorinë TI për pezullimin (mbylljen) e përdoruesit në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve.

Drejtoria TI pezullon (mbyll) përdoruesin dhe vijon komunikimin me personin e autorizuar TI të shoqërisë së sigurimit.

ANEKSI 5

LLOJET DHE STATUSET E POLICAVE TË RAPORTUAR NË REGJISTRIN ELEKTRONIK ONLINE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM MOTORIK

➤ Llojet e policave

Llojet e policave përcaktohen/identifikohen sipas formatit të fushës KODI_LLOJIT_POLICËS, e cila merr vlerat:

1. TPL e Brendshme;
2. Karton Jeshil;
3. Policë Kufitare;

➤ Periudha e vlefshmërisë së policave

Në varësi të periudhës, e cila përcaktohet / identifikohet sipas formatit të fushës KODI_PERIUDHËS, llojet e policave kategorizohen sipas periudhave të mbulimit:

- Policat TPL janë vetëm për periudhën 1 Vjeçare;
- Kortoni Jeshil janë për periudhat 15 Ditore, 1, 3, 6 Mujore dhe 1 Vjeçare;
- Policat kufitare janë për periudhën 15, 30, 45 Ditore dhe 6 Mujore.

➤ Statuset e policave

1. Statusi 1

Policat e shitura që identifikohen dhe raportohen në Regjistrin Elektronik Online të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik identifikohen me status 1.

2. Statusi 2

Pas çdo anulimi nga përdoruesit e autorizuar të policës së raportuar e shitur në Regjistrin Elektronik Online të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, statusi i policës kalon 2 dhe ruhet dhe data e ndryshimit të këtij statusi.

3. Statusi 3 dhe 4

DUBLIKATA është një kopje e një police të vlefshme, e cila lëshohet nga po e njëjta shoqëri sigurimi dhe për të njëjtin mjet. Rastet kur lëshohet një dublikatë janë:

- Në momentin e ndryshimit të pronësisë së mjetit;
- Në momentin e modifikimit teknik në mjet;
- Në momentin e humbjes së kartonit;
- Etj

Për dublikatën gjenerohet një numër unik i ri (kodi_policës) dhe datë të re raportimi në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve, por me periudhë mbulimi të njëjtë me policën e dublikuar. Polica e dublikuar merr statusin 3 dhe polica dublikatë e vlefshme që raportohet në Regjistrin Elektronik Online të Sigurimit të Detyrueshëm motorik me statusin 4, e cila lidhet me kodin e policës dhe numrin e serisë së policës së dublikuar.

4. Statusi 5

Policat në statusin “KTHYER” raportohet për rastet kur klienti kërkon të ndërpresë në mes të periudhës së vlefshmërisë, kontratën e sigurimit të detyrueshëm duke ju kthyer edhe një pjesë e primit dhe pagesës. Procesi i kthimit të primit të policave kryhet nga përdoruesit e autorizuar, duke përditësuar statusin në 5 dhe ruhet edhe data e ndryshimit të këtij statusi.